



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE TIRANË

SHKOLLA E MESME PROFESIONALE

INDUSTRIALE "PAVARËSIA" VLORË

Nr. 1445 Prot

Vlorë , më 04.11.2024

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele .

Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore ,

Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun".

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE TIRANË

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr 759 datë ,30.09.2024, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësive të zhvillimit të institucioneve , ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit ",

Ofruesi publik i AFP-së SHKOLLA INDUSTRIALE "PAVARESIA "VLORE , ju njofton krijimin e vendit të lirë për 1 pozicione pune :

- Pozicioni 1 .

Dega-ELEKTROTEKNIKË për mesues të teorisë dhe / ose të praktikës profesionale (me kohë të plotë)

Kriteret të përgjithshme dhe kriteret e posaçme.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryej detyrën
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar

e) të demonstrojë vlera të larta të etikës ,sjelljes dhe komunikimit

f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për mesues të teorisë dhe / ose të praktikës profesionale (me kohë të plotë) në ofruesit e AFP-së për lëvizjen paralele si vijon:

a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barasvlershme ,në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së.

b) të ketë të paktën 1(një)vjet përvojë pune në fushën ,më të cilat ka kryer studimet

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

d) aftësi të tjera nëse kërkohen

Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit për lëvizje paralele , duhet të përfshijë: -

a) letërmotivimin për pozicionin;

b) jetëshkrimin (CV-në) sipas shtojcës 11 të udhëzimit Nr.759 ,datë 30.09.2024;

c) kartën e identitetit;

d) diplomën + listen e notave (bachelor dhe master);

e)- librezën e punës;

f) - çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

g)- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

h) - vërtetimin e gjendjes shëndetësore;

i) - vërtetimin e gjendjes gjyqësore;

j) - vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi

k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

2. Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre ;

3. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të ofruesit public të AFP-së, brenda datës , 13.11.2024

DREJTORE

ING.GENTIAN BOCI